

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

MIRATOHET

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Dritan LELI



SISTEMI MULTIFUNKSIONAL “SMART CITY” LUNGOMARE

Versioni 1.0

Data __/__/2017

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT

Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit

Data	Autori	Versioni	Shënime mbi Rishikimet
__/__/2017		1.0	



NËNSHKRIMET MIRATUESE

Miratoi: **Drejtuesi i Projektit**

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Miratoi: **Përgjegjës për Proceset TIK**

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Përgatiti: **Përgjegjësi TIK**

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Përgatiti: <Funksioni i Anëtarit të Grupit të Punës për Hartimin e Termave të referencës, mund të shtohen të tjerë>

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Person kontakti:

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>


Rishikoi: **Përgjegjësi i Sigurisë së TIK-ut**

<Emri Mbiemri>

<Nënshkrimi>

Të dhënat e personit të Kontaktit:

Emër/Mbiemër	
Pozicioni	
Adresa e-mail	
Nr. tel	



PËRMBAJTJA

ANEKSI 1 – TERMA REFERENCE PËR PROJEKTET TIK	1
FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT	2
Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit	2
NËNSHKRIMET MIRATUESE	3
Të dhënat e personit të Kontaktit:	3
PËRMBAJTJA.....	4
1. HYRJE	6
1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues	6
1.2. Historiku.....	6
1.3. Situata Aktuale në Sektor	6
2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	7
2.1. Objektivi i Përgjithshëm.....	7
2.2. Qëllimi.....	7
2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori	7
3. SUPOZIMET DHE RISQET	8
3.1. Supozimet e Projektit	8
3.2. Risqet.....	8
4. QËLLIMI I PUNËS	10
4.1 Të Përgjithshme.....	10
4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet	13
4.1.3 Grupet e synuara	13
4.1.4 Siguria e sistemit.....	14
4.2 Detyrat specifike	14
5.1 Vendndodhja	14
5.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	14
6. RAPORTIMI.....	14
6.1 Kërkesat e Raportimit.....	15
6.2 Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve	15
7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA	15
8. GARANCIA	15
9. MIRËMBAJTJA	16
10. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT Error! Bookmark not defined.	
11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT	17
12. TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT	17
13. KËRKESAT FUNKSIONALE.....	18

13.2 Raporte.....	18
14. KËRKESAT TEKNIKE	19



1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Bashkia Vlorë

1.2. Historiku

Vlora është qyteti më turistik i Shqipërisë për shak të diversitetit të relievit, ndërthur me oferten e turizmit historik dhe atij bregdetar. Numri i turistëve vendas dhe të huaj rritet nga viti në vit në këtë qytet i cili quhet ndryshe “perla e Jugut”.

Një prej projekteve më ambicioze dhe më të mëdha të viteve të fundit është ndërtimi i shëtitores përgjatë vijës bregdetare Vlorë-Uji i Ftohtë, e cila njihet me emrin Lungomare. Ky projekt do të kthehet në një prej atraksioneve më të mëdha të qytetit.

Vlora ka një përvojë për ofrimin e shërbimit internet në zona publike me anë të një projekti pilot i realizuar nga Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal (AULEDA), në bashkëpunim me bashkinë, në kuadër të projektit PITAGORA (Platformë e përbashkët komunikimi dhe informacioni në zonën e Adriatikut IPA Adriatik), financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt fokusohet vetëm mbi ofrimin e shërbimit free Wi-Fi në qendër të qytetit por i pashoqeruar me funksionalitete të tjera.

Bazuar në statistikat e fundit rreth përdorimit të internetit në pajisjet smart, aksesi në internet në çdo kohë dhe nga çdo vend të qytetit është bërë i domosdoshëm. Gjithashtu, duhet patur parasysh që një shërbim i tillë është tepër i pëlqyer edhe nga turistët që vizitojnë qytetin numri i të cilëve po rritet çdo vit.

1.3. Situata Aktuale në Sektor

Deri me sot, thuhet se asnjë qytet nuk ka pasur një sistem multifunksional “Smart City” për internet wireless pa pagesë, rrjet fibre optike, semafore inteligjente, stola inteligjente, sistem monitorimi, sistem ndricimi inteligjent etj. Shpesh disa nga kompanitë e telefonave celularë në periudha kohore të caktuara kanë ofruar internet falas në rruget e qytetit por cilësia ka qenë e dobët. Bashkia duke parë nevojën e ndërthurjes së disa shërbimeve në një rrjet “Smart”, ka vendosur realizimin e këtij projekti. Në vitin 2014 gjithashtu është realizuar një projekt pilot i realizuar nga Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal (AULEDA), në bashkëpunim me bashkinë Vlorë, në kuadër të projektit PITAGORA (Platformë e përbashkët komunikimi dhe informacioni në zonën e Adriatikut IPA Adriatik), financuar nga Bashkimi Evropian.

Gjithashtu gjatë muajëve të sezonit turistik Telekom Albania ka ofruar shërbim ëi-fi falas në katër pika të qytetit. Aktualisht internet falas nëpërmjet Wi-Fi ofrohet në shumë prej bareve dhe restoranteve të qytetit të Vlorës por jo në zona publike dhe në plazhe. Në të kaluarën ka patur edhe iniciativa të tjera për ofrimin e këtij shërbimi sic mund të përmendim Vodafone Albania apo edhe Posta Shqiptare por këto projekte mund të quhen të përfunduara apo më keq të dështuara, ku shkaqet e dështimit janë marrë parasysh edhe në këtë projekt për eliminimin e tyre.

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Realizimi i këtij projekti do të arrijë objektivat e mëposhtme:

- Ndërtimin dhe përgatitjen e infrastrukturës pasive dhe aktive të telekomunikacionit për një zgjidhje “Smart City” përgjatë shetitores Lungomare.
- Ndërtimin e një sistemi Wi-Fi në pikat me dendësi të lartë përdorimi nga publiku, dhe ato që frekuentohen nga turistët nëpërmjet teknologjive multifunksionale përgjatë shetitores Lungomare.
- Vendosjen e Stolave “Smart” përgjatë shetitores Lungomare.
- Module të karikimit të telefonave “Smart” për qytetarët dhe turistët përgjatë shetitores Lungomare.
- Vendosjen e kamerave me cilesi të lartë përgjatë shetitores Lungomare.
- Përgatitjen e infrastrukturës ekzistuese për projektet e ardhshme “Smart City”

2.2. Qëllimi

Qëllimi kryesor që duhet të arrihet me realizimin e këtij projekti është implementimi i një sistemi multifunksional teknologjik që do të mundësojë një rrjet komunikimi të shpejtësisë së lartë i bazuar mbi fiber optike, shërbim wi-fi free, monitorim nëpërmjet kamerave të sigurisë, vendosjen e pajisjeve të karikimit të telefonave “Smart” përgjatë shetitores Lungomare si dhe përgatitja e rrjetit për suportin e shërbimeve të tjera “Smart”

2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Kontraktori do të ndërtojë infrastrukturë dhe një sistem i cili duhet të jetë i qëndrueshëm, multifunksional, që të shpërndajë internet pa pagesë për qytetarët. Kontraktori do të mundësojë vendosjen e pajisjeve karikuese për telefonat “Smart” nëpërmjet energjisë diellore, si dhe instalimin e kamerave për monitorimin e Lungomare.

Rezultatet e pritshme në përgjigje të objektivave dhe qëllimeve të vëna më sipër janë:

Implementimi i një infrastrukture aktive dhe pasive si dhe të një sistemi që do të merret me manaxhimin e procesit të përshkruar më sipër, duke përfshirë:

Ndërtimin e një rrjeti komunikimi të bazuar mbi Fibër optike nga Bashkia Vlorë deri në fund të gjatësisë së Lungomare.

Krijimi i infrastruktures se nevojshme per sistemin wi-fi

Krijimi i infrastruktures se nevojshme per sistemin e monitorimit nëpërmjet kamerave të sigurisë.

Insatalimi i stolave inteligjente.

Instalimi i pajisjeve te shpendarjes wifi ne terren (access point) përgjatë Lungomare.

Instalimin e kamerave me rezolucion të lartë përgjatë Lungomare.

Instalimin e pajisjeve të karikimit për telefonat “Smart” përgjatë Lungomare.

Instalimin e stolave “Smart” përgjate Lungomare.

Konfigurimi i pajisjeve

Testim i sistemit

Trajnimi i përdoruesve të bashkisë

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Realizimi i këtij projekti do të bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Pjesëmarrje aktive dhe disponibilitet i të gjithë palëve të interesuara në implementimin e këtij projekti.
- Vënia në dispozicion e infrastrukturës së nevojshme për implementimin e sistemit.
- Alokimi i burimeve njerëzore të nevojshme për implementimin e këtij projekti.
- Realizimi në kohë i projektit.

3.2. Risqet

Çdo projekt permban risk dhe si rrjedhoje një numër i madh teknikash janë zhvilluar për ta vlerësuar dhe administruar atë. Megjithatë, ekzistojnë rreziqe në lidhje me afatet kohore dhe efektshmërinë e implementimit të aktiviteteve të cilat mund të kenë një impakt negativ për arritjen e rezultateve përfundimtare.

Tre aspektet kryesore në këtë drejtim mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Identifikimi i Riskut

Një analize sistematike e riskut mund të mundësojë:

- i. një kuptim më të mirë të fushave të riskut
- ii. kuptim dhe njohuri më të mira për pikat kritike të projektit si dhe vendime të dokumentuara dhe arsyetime të cilat mund të rishikohen lehtë më vonë.

Hapat për identifikimin e riskut janë:

- a. Analiza e projekt – planit dhe rishikimi pas çdo detyre, pas çdo lëvrimit, faze të projektit.
- b. Identifikimi për çdo komponent i ndonjë risku të mundshëm.
- c. Mbledhja dhe grupimi i risqeve në një listë risku.
- d. Gjetja e zgjidhjes (kundër-veprimi) për çdo risk mundësisht, duke vërtetuar me kujdes nëse si kundër-veprim mund të vijë një risk i dytë.

2. Vlerësimi i Riskut

Jo të gjitha risqet kanë rëndësi të njëjtë, kështu që lista e riskut duhet të rivlerësohet dhe vetëm risqet e rëndësishme duhet të përfshihen në aktivitetet e administrimit të riskut.

Vlerësimi i riskut prodhon informacionin e mëposhtëm:

- a. Mundësinë për grupin e realizimit të projektit për të konsideruar çdo risk.
- b. Një plan-veprimi për çdo risk
- c. Llogaritje burimesh dhe kostosh për çdo risk
- d. Pika kontrolli për monitorim dhe administrim

3. Administrimi i Riskut

Aktivitetet për administrimin e riskut mund të përmblihen në hapat e mëposhtëm:

- a. Prodhimi dhe përditësimi i listës së veprimeve për riskun
- b. Monitorimi i implementimit të strategjisë kundër riskut
- c. Raportimi i ecurisë së projektit dhe identifikimi i pikave kritike që vijnë.
- d. Rishikimi i ecurisë së çështjeve me risk
- e. Rishikimi dhe ndryshimi i përgjegjësive për riskun.

Risk për t'u konsideruar është koha e nevojshme për të sinkronizuar procedurat e prokurimit, kohën e domosdoshme për zhvillimin, konfigurimin dhe testimin e shërbimeve elektronike.

Një risk me prioritet dhe ndikim të lartë në projekt është suporti nga vetë institucioni i Bashkisë Vlore dhe paleve të treta të interesuara, për të ndihmuar në njohjen sa më të mirë të secilit prej shërbimeve si dhe workflow e procesimit të tyre.

<i>Risku</i>	<i>Impakti</i>	<i>Probabiliteti</i>	<i>Masat për eliminim</i>
--------------	----------------	----------------------	---------------------------

<i>Bashkëpunimi i institucioneve të cilat kanë lidhje me këtë projekt nuk është siguruar në kohën dhe fazën e duhur.</i>	<i>I ulët</i>	<i>Mesatar</i>	<i>Që me fillimin e projektit procesi i komunikimit dhe i bashkëpunimit do të negociohet, me qëllim që të sigurohet bashkëpunim i plotë me të gjitha institucionet e përfshira.</i>
<i>Sigurimi i burimeve njerëzore dhe financiare dhe për sigurimin e operimit të mëtejshëm në drejtim të zhvillimit dhe mirëmbajtjes të aprovuar në përgjithsi apo ndryshime të veçanta nuk është i garantuar.</i>	<i>I lartë</i>	<i>Mesatar</i>	<i>Levrimi i shpejte dhe rezultatet e mira te arritura do te ndihmojne per sigurimin e nje mbeshtetje te vazhdueshme per zhvillime te metejshme te sistemit. Gjithashtu paraqitja plani mbeshtetje dhe zhvillimi te besueshem do te ndihmojne ne procesin e alokimit te resurseve te nevojshme.</i>
<i>Gatishmëria e stafit të Bashkisë Vlorë për përdorimin e sistemit të ri.</i>	<i>I lartë</i>	<i>I ulët</i>	<i>Kontraktuesi do të realizojë sesione trajnimi për grupe të veçanta përdoruesish, të cilët do të aftësohen të veprojnë si trajnues për punonjësit e tjerë.</i>

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1 Të Përgjithshme

Bashkia Vlorë e mbështet punën e saj në bazë të:

- Ligjit Nr.8652, datë 31.07.2000: “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Qeverisjes Vendore
- Ligjit Nr. 9208, datë 18.03.2004: “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000; “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Qeverisjes Vendore”
- Ligjit Nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000”, “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” të ndryshuar.
- Ligjit Nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse. Bashkia Vlorë, në kuadër të këtij legjislacioni dhe procedurave të brendshme të saj, synon të implementojë sistemin për ndërtimin e një rrjeti dhe sistemi multifunksional në funksion të zgjidhjeve të “Smart City”.


4.1.1 Përshkrimi i detyrës

Ky projekt ka si qëllim ndërtimin e një rrjeti komunikimi pasiv dhe aktiv ku do të mbështetet komunikimi i të gjitha pajisjeve informatike të cilat do të jenë pjesë e këtij projekti por do të shërbejë edhe për të ardhmen. Rrjeti telekomunikacionit që do të ndërtohet do të përbëhet nga

rrjeti pasiv i cili do të ketë pjesë të vetën tubacionet dhe pusetat në të gjithë gjatësinë nga bashkia Vlorë deri në pikën më të largët të Lungomare si dhe aksesorët e tjerë për suportin e rrjetit aktiv. Rrjeti aktiv do të ndërtohet i bazuar mbi Fibër optike, pasisje qendrore dhe terminale do të jenë bazuar mbi teknologjinë IP, Switch për terminimin dhe manaxhimin e trafikut IP, Pajisje server qendrore për manaxhimin e shërbimit të sigurisë, platforme cloud për manaxhimin e shërbimit wireless Wi-Fi, kamera të jashtme të cilësisë së lartë së bashku me aksesorët e montimit dhe pajisjet e ruajtjes së informacionit, Stola inteligjente të cilët kanë të inkuorporuar pajisjet access-point wireless wi-fi dhe ushqyesit për pajisjet "Smart", panelin diellor së bashku me modulën e karikimit dhe stabilizimit të rrymës si dhe të gjithë aksesorët e tjerë për ndërtimin e rrjetit të Fibrës optike. Më poshtë jepen të gjithë komponentët e projektit.

Rrjeti i fibres optike

Në kohët e sotme të gjithë rrjetet e komunikimit të cilat po ndërtohen janë të bazuar mbi fibër optike si një media me kapacitet teorik të transmetimit infinit. Për ndërtimin e këtij rrjeti paraprakisht do të duhet të ndërtohet infrastruktura pasive e përberë nga të gjithë elementët e domosdoshëm për këtë rrjet. Gjatësia e rrjetit do të jetë përgjatë trasesë Bashkia Vlorë – Fundi i Lungomare me opsionin për tu zgjeruar më tej deri në pikën më të lartë të rrugës Uji Ftohtë – Radhimë në pikën e njohur si Fari. Gjurma e këtij rrjeti jepet si më poshtë:



Tubacioni që do të ndërtohet për kalimin e rrjetit të fibres optike do të jetë me diametër 100 mm pasi në të ardhmen do të duhet të përdoret nga bashkia Vlorë për t'ja vënë në dispozicion edhe operatorëve privatë apo publikë që do të duan të ndërtojnë rrjetet e tyre të komunikimit. Rrjeti pasiv do të shoqërohet nga pusetat utilitare të cilat do të përdoren për shtrimin e fibres optike apo për vendosjen e aksesorëve gjatë vijimit apo dhe në rast të degëzimit. Materiali i këtyre pusetave duhet të jetë rezistent për të siguruar një jetëgjatësi maksimale prej 20 vjetësh dhe me përmasa 60x60x60cm dhe distancë nga njëra tjetra prej 100m. Gjatësia e tubacionit në total është 7000 m.

Rrjeti i fibres optike që do të ndërtohet do të bazohet mbi fiber optike me 48 fije për instalime nëntokësore me transmetim valor Single Mode. Do të vendoset ky kapacitet fijesh për tu përdorur më vonë nga bashkia për qëllime të tjera ku përfshihen lidhja institucioneve publike që varen nga bashkia, arsimore, shëndetësore, sportive etj. Gjithashtu ky rrjet do të shërbejë për zgjerimin e rrjetit të kamerave të sigurisë, komunikimin me semaforet inteligjente apo tabelat informuese inteligjente si dhe elementë të tjerë në të ardhmen për "Smart City". Duke patur parasysh rezervat e FO që do të lihen gjatë trasesë për korrigjimin e defekteve të mundshme në të ardhmen në total do të shtrohen 8000m fiber optike. Fibra që do të përdoret duhet të jetë e

dedikuar për instalime nëntokësore, rezistente nga brestësit dhe sipas specifikimeve teknike në kreun 14.

Komunikimi në nivelin L2 do të realizohet nëpërmjet përdorimit të teknologjisë IP dhe në këtë mënyrë kapaciteti i lidhjes së çdo terminali do të jetë 1Gbps ndare në Vlan perkates. Në ambjentet e bashkisë në dhomën e pajisjeve do të instalohet pajisje switch qendror dhe firewall, ndërsa në çdo terminal do të vendosen pasijset fundore switch industrial.

Rrjeti i manaxhimit

Rrjeti i manaxhimit do të përbëhet nga shumë elementë aktivë ku rolin kryesor e ka Switch-i qendror apo Core Switch. Ky switch duhet të ketë minimumi 20 porta optike si dhe minimumi 2 porta upstream me kapacitet të lartë për tu përdorur në të ardhmen. Karakteristikat teknike të këtij switch jepen gjithashtu në kapitullin 14. Element tjetër i këtij rrjeti është platforma cloud e manaxhimit të rrjetit wireless që bën të mundur funksionimin e njekohshëm të më shumë se 1000 përdoruesve në rrjet.

Për publikimin në internet të funksioneve të këtij rrjeti do të përdoret një firewall profesional, me kontratë për antispam, antivirus e anti-intrusion.

Sistemi i monitorimit me kamera do të ketë njësinë qendrore të administrimit të imazheve dhe të menaxhimit të sistemit në tërësi, të instaluar në një pajisje profesionale në sallën qendrore të pajisjeve.

Stolat inteligjente do të kenë administrim qendror në "cloud" nëpërmjet të cilit do të kontrollohen dhe komandohen parametra të veçanta funksionale dhe estetike të tyre.

Stolat inteligjente

Stolat inteligjente janë një risi teknologjike e kohëve të fundit të cilat po gjejnë një përdorim gjithmone dhe më të madh në qytetet turistike dhe metropolet në botë. Këta stola qëllimin primar kanë uljen e njerëzve në to për relaks apo shlodhje, dhe për këtë qëllim dizenjimi dhe materiali që do të përdoret është i një cilësie shumë të lartë. Pjesa e sipërme e tyre duhet të përbëhet nga një panel diellor i cili do të prodhojë energji elektrike që furnizon me energji pajisjet e vendosura brenda stolit. Brenda stolit duhet të instalohet një sistem i integruar me elementët që kthejnë energjinë diellore në energji elektrike, rregullatori i karikimit, stabilizatori, bateria, routeri wireless si dhe konverterat për furnizimin me energji të portave USB të cilat shërbejnë për karikimin e pajisjeve "Smart". Materiali i këtyre stolave duhet të jetë antivandal dhe rezistent ndaj kushteve atmosferike në kategorinë IP67.

Sistemi Wireless Wi-Fi

Për të krijuar zonën e kërkuar me wireless, kërkohet të instalohen një numër pajisjesh hardware wireless Access Point. Këto pajisje lidhen logjikisht me wireless kontrollerin, i cili do të bëjë menaxhimin e të gjithë sistemit, mbajtjen e logeve, si një ndërfaqe e vetme e shkallëzuar për menaxhimin e të gjithë infrastrukturës.

Përgjatë gjithë gjatësisë së shëtitorës Lungomare do të instalohen 20 pajisje Access Point në një distancë 200 m nga njëri tjetri dhe me rreze mbulimi 100 m. Pajisjet wi-Fi do të instalohen në të njëjtat vende ku do të instalohen edhe kamerat të cilat do të lidhen me infrastrukturën qendrore nëpërmjet pajisjeve switch industrial.

Sistemi i kamerave

Si u përmend edhe më lart rrjeti i kamerave do të ndërtohet në zbatim të plotë me Ligjin Nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” i cili përcakton instalimin e kamerave të sigurisë me rezolucion të lartë në hapsirat publike.

Hapësira që do të monitorohet do të jete hapësirë publike pedonale, ku qytetaret do të shetisin lirshëm me familjet e tyre. Për këtë arsye gjykojmë që në këto ambiente të vendosen kamera me cilësi të lartë, rezistente ndaj kushteve klimatike bregdetare dhe me një rezolucion që lejon monitorim të ambientit pa thyer privatesinë e qytetareve.

Për këtë arsye kamerat do të kenë një rezolucion jo më të lartë se 3 MP.

Kerkese thelbësore është që kamerat të kenë përgjigje perfekte ndaj ndryshimeve dinamike dhe të paparashikuara të ndricimit të ambientit të hapur bregdetar. Kamerat duhet të jenë të kategorisë profesionale me kapje të imazhit dinamik (Forensic Capture ose ekuivalente).

Theksohet që ndërtimi i këtij rrjeti komunikimi do të krijojë mundësinë e lidhjes në të njëjtën kohë të pajisjeve të tjera “Smart” ku mund të përmendim Semaforet Inteligjente së bashku me sensorët përkatës, modulet e komandimit të ndriçimit inteligjent, tabelat reklamuese inteligjente, sisteme IoT etj.

4.1.2 Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Bashkia Vlorë në gjatësinë e Lungomare.

4.1.3 Grupet e synuara

Ky projekt synon grupet e mëposhtme të interesit:

- Qytetaret
- Vizitore vendas dhe të huaj në territorin e Bashkisë
- Njesite administrative të Bashkisë
- Policia dhe Prokuroria Vlorë.
- Institucionet publike në bashkinë Vlorë

4.1.4 Siguria e sistemit

Sistemi duhet te jete i mbrojtur nga sulme kibernetike, trafiku te jete i enkriptuar edhe platforma e manaxhimit duhet te jete e sigurt. Gjithashtu nivelet e aksesit duhet te jene të qarta dhe të specifikura për cdo përdorues.

4.2 Detyrat specifike

Në kuadër te qellimit kryesor të këtij projekti për ndërtimin infrastrukturës, sistemit wi-fi free, instalimit të stolave inteligjente si dhe sistemit të kamerave përgjatë gjatësisë së Lungomare, i gjithë projekti duhet të ndërtohet mbi detyrat e mëposhtme:

1. Përcaktimi i planit të punës për ekzekutimin e projektit
2. Ngritja e grupeve të punës nga palët e interesuara
3. Infrastruktura e rrjetit pasiv (Tubacione, puseta, aksesore)
4. Infrastruktura e rrjetit aktiv (Fibër optike, POP, switch dhe GW industriale, aksesore)
5. Instalimi i platformes menaxhuese dhe pajisjeve të kontrollit.
6. Instalimi i Stolave “Smart” multifunkionale
7. Instalimi i kamerave të monitorimit.
8. Instalimi i rrjetit Wi-Fi
9. Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve ne terren
10. Konfigurimi i sistemit
11. Testimi dhe dokumentimi i pranimi të përdoruesit
12. Përgatitja e materialeve udhëzuese dhe trajnimi i përdoruesve
13. Marrja në dorëzim e projektit nga autoriteti kontraktues
14. Raportimi i çdo faze të projektit te menaxherët e projektit

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1 Vendndodhja

Bashkia Vlorë

5.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data kur do te behet nenshkrimi i kontrates per realizimin e ketij projekti dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë 3 muaj nisur nga kjo datë.

6. RAPORTIMI

6.1 Kërkesat e Raportimit

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe në origjinal dhe në dy kopje (për arsye mjedisore, kërkohet sa më pak kopje të letrës të jetë e mundur).

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 12 faqesh duhet të prodhohet brenda 3 javëve nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** numri maksimal i faqeve 12 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se një muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2 Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar në kontratë. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Ky sistem qe do te ndertohet nuk do te kete komunikim me sisteme te tjera. Ai do te jete i hapur per zgjerime kapacitetesh si dhe per te realizuar funksione te tjera ne te ardhmen si semaforet inteligjente, sistem informimi digital, ndricimi inteligjent etj.

8. GARANCIA

Garancia per rrjetin FO, stolat "Smart", rrejtin Wi-Fi, sistemin e kamerave dhe te gjitha pajisjeve aktive eshte min 1 vit (per pajisjet hardware).

9. MIRËMBAJTJA

Mirëmbajtja në përputhje me dispozitat e VKM-së nr. 710, datë 21 gusht 2013, “Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit” do të jete 4 (kater) vjet

10. Formulari i cmimit te ofertes

Nr.	Emertimi	Sasia	Cmimi Leke pa TVSH	Vlera Leke pa TVSH	Koha e levrimit
1	Rack 42 U së bashku me aksesoret	1			
2	UPS ne qendrën e bashkisë	1			
3	Switch Core	1			
4	Firewall me kontrate antivirus dhe anti intrusion	1			
5	Access Point Wi-Fi	20			
6	Rrjet Fiber optike 48SM (ml)	8000			
7	Kabllimi elektrik (ml)	4000			
8	Switch industrial	30			
9	Stola Inteligjente	20			
10	Kamera outdoor me forensic capture perfshire aksesoret e montimit origjinale	20			
11	NVR dhe storage me kapacitet 16TB	1			
12	Videoclient workstation	1			
13	Kuti hermetike	20			

14	Media konverter switch industrial	20			
15	Blllok ushqimi industrial	20			
16	Sherbim aksesi ne internet 100Mbps (muaj)	12			
	Totali projektit (leke pa tvsh)				
	TVSH 20%				
	Total I projektit me tvsh				

11. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Në *diagramën* më poshtë jepen në vija të përgjithshme afatet kohore për implementimin e sistemit.

Nr	Emërtimi i fazës/Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	...	M11	M12	M13 - M60
1	Faza Përgatitore për sistemin	x	x									
2	Lëvrimi i pajisjeve hardware		x									
3	Faza e montimit dhe konfigurimit		x	x								
4	Faza e integritimit dhe testimit		x	x								
5	Trajnimi i përdoruesve			x								
6	Marrja në dorëzim			x								
7	Fillimi i procesit të mirëmbajtjes			x								

12.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

Ne kete projekt nuk do te kete zhvillim aplikacioni, por çdo konfigurim, skeme lidhjeje apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me kete sistem do t'i kalojë përfituesit në format elektronike dhe në letër.

13.KËRKESAT FUNKSIONALE

Në këtë projekt është menduar që shërbimi i internetit të ofrohet nga bashkia nëpërmjet një burimi qendror të internet.

- Rrjeti pasiv duhet të ndërtohet me materiale cilësore dhe me jetëgjatësi jo më të vogël se 10 vjet.
- I gjithë rrjeti aktiv dhe sistemi duhet te realizohet duke perdorur marka brand.
- Rrjeti i fibrës optike duhet të jetë i standartit nëntokësor dhe antibrejtës.
- Të gjitha akses pointet wireless, stolat “Smart” dhe kamerat duhet të jenë per instalim ne ambiente te jashtme.
- Të gjithë akses pointet, stolat “Smart” dhe kamerat duhet të jenë të përshtatshëm për klimën dhe kushtet atmosferike bregdetare në Vlore
- Të gjitha pajisjet të jenë në punë 24x7x365
- Disponueshmëria e sistemit duhet të jetë mbi 95% vit
- Sistemi Wi-Fi duhet të jetë i konfigurueshëm të drejtojë klientët në një faqe të dedikuar

13.1 Funkcionalitete dhe Bllokskema

Per te krijuar zonën e kërkuar me wireless, kërkohet te instalohen nje numër pajisjesh hardware. Keto pajisje perbehen nga wireless kontrolleri, i cili do te bej menaxhimin e te gjithë sistemit, mbajtjen e logeve, etj; si nje ndërfaqe e vetme e shkallëzuar për menaxhimin e të gjithë infrastrukturës

13.2 Raporte

Sistemi wifi free do të krijojë mundësinë e grumbullimit te disa te dhenave lidhur me perdoruesit e pajisjeve, te cilat me pas do te mund te perpunohen dhe paraqiten ne forme raporti. Pra, ne momentin e lidhjes se qytetarit ne sistem, perdoruesit do t'i paraqitet nje formular per t'u plotësuar (jo me detyrim), per te marre te dhena dhe per studime te ndryshme. Gjithashtu nga stolat inteligjente do të merren parametrat klimaterike të cilat gjithashtu mund të përdoren për studime të ndryshme.

Disa nga raportet që mund të gjenerojë sistemi janë:

1. Faqet me të vizituara, orët me më shumë trafik ku sistemi është më i ngarkuar etj. rezultatet e të cilave mund të ndihmojnë për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.
2. Numri i përdoruesve në ditë që aksesojnë wifi free në çdo pikë.
3. Temperatura dhe lagështia në çdo stol “smart”



14.KËRKESAT TEKNIKE

Stolat Inteligjente

Specifikimet teknike minimale të domosdoshme të stolave:

- Stolat do të prodhohen sipas një designi të përshtatshëm për të instaluar në Lungomare. Ata do të jenë me material që nuk ndryshket edhe nëse gërvishen nga keqberesit, të lyer me bojë të bardhë. Materiali duhet të jetë kundër korrozionit, i rezistueshëm ndaj ujit të kripur apo kimikateve.
- Siperfaqja horizontale do të jetë me material rezistent, antivandal.
- Në materialin antivandal duhet të instalohen qelizat diellore të prodhimit të energjisë.
- Në kornizën që rrethon panelin diellor, do të instalohen shirita me drita dekorative me së paku tre ngjyra të ndryshme. Këto drita programohen nëpërmjet softwarit në cloud,

dhe mund ti ndryshohet ngjyra sipas deshires, me skedul apo ne varesi te ndricimit te ambientit.

- Ne brendesi te stolit duhet te jene instaluar pajisjet industriale te konvertimit te energjise, ruajtjes se saj, stabilizimit dhe shnderrimit ne tension te pershtatshem per te ushqyer: Ruterin 3G/Wifi qe do te shperndaj internet ne nje rreze prej 20m rreth e qark stolit, karikuesat USB, ndricuesin dekorativ, dhe ndricuesin funksional qe duhet te jete i instaluar ne pjesen e poshtme te stolit.
- Ndricuesi funksional duhet te ndricoje ambientin rreth e qark ne nje rreze jo me pak se 2 m nga stoli.
- Energjia e prodhuar dhe ruajtur nga stolui, duhet ti garantoje atij nje autonomi prej jo me pak se 48 oresh, per rastet kur nuk ka diell per disa dite.
- Temperatura e siperfaqes se stolit, ne pjesen ku ulen njerezit, duhet te jete e klimatizuar nepermjet ventilimit.
- Stoli duhet te kete se paku dy porta USB per karikim te telefonave momil
- Stoli duhet te ofroje lidhje ne internet me WiFi te perdoruesve me shpejtesi deri ne 150Mbps, dhe duhet te garantoje nje homepage te personalizuar nga Bashkia Vlore, si dhe kufizime te numrit te faqeve apo shpejtesise se insternetit.
- Stoli duhet te jete i afte qe nese nuk po perdoret nga askush, te fiket automatikisht ne menyre qe te kurseje energji.
- Stoli duhet te kete te instaluar sensore qe dallojne numrin e perdoruesve te tij, si dhe sensore atmosferike.
